



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

Legjislatura VI  
Sesioni vjeshtor

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 4  
Prishtinë, më 05.12.2017, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

**Mungoi:** Elmi Reçica.

Në mbledhje ishte prezent për raportim ministri i MeDIS, z. Dardan Gashi me bashkëpunëtorët: Avdyl Lipoveci, Burim Krasniqi, Shyhrete Gosalci dhe Kreshnik Berisha.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Agnesa Haxhiu, KDI; Besmir Radoniqi, Valtrim Hasani, Fillesë Demaku, praktikantë; Gurjeta Zeka, LVV dhe media.

**Nga zyra e komisionit:** Minire Hasani, Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30 tetor 2017;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30 tetor 2017**

*Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30 tetor 2017.*

### **3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, tha se ministri është ftuar në komision, që të raportojë lidhur me planet dhe politikën e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për promovimin e rolit të diasporës, si dhe për fushëveprimin e ministrisë, lidhur me investimet strategjike. Ajo propozoi që ministri Gashi të raportojë në komision çdo tre muaj.

**Dardan Gashi**, njoftoi se janë nënshkruar tri marrëveshje me Republikën e Shqipërisë. Marrëveshja e parë ka të bëjë me fuqizimin e qendrave kulturore dhe se Kosova i ka 5 qendra kulturore, prej të cilave 3 janë aktive. Ai, po ashtu, tha se qendrave kulturore do t'iu ndryshohet emërtimi dhe do të quhen Qendra të Shteteve Shqiptare. Atyre do t'iu ndryshohet karakteri dhe nuk do të merren vetëm me kulturë, por do të merren edhe me asistencë juridike dhe sociale për bashkatdhetarët tanë. Çështje problematike për funksionimin e qendrave kulturore, ministri i cilësoi çështjet juridike të tyre në ato vende ku veprojnë, si dhe Ligjin e Diasporës. Në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë, theksoi se janë duke punuar në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi. Marrëveshja tjetër ka të bëjë me arsimin, aktivitetet e ndryshme kulturore, përzgjedhjen e mësuesve, financimin, si dhe aktivitetet tjera, të cilat bëhen në koordinim të plotë me Republikën e Shqipërisë. Lidhur me financimin e këtyre marrëveshjeve, ministri njoftoi se financimi do të bëhet në mënyrë të barabartë nga të dy palët. Çështje tjetër e rëndësishme, tha se janë rrjetet e biznesit dhe njoftoi se kishte një takim me përfaqësues të këtyre rrjeteve nga Evropa, Kanadaja dhe Australia. Ai, po ashtu, tha se janë duke vazhduar diskutimet me përfaqësuesit e këtyre rrjeteve se si ata mund të ndihmojnë në sjelljen e investimeve strategjike. Ministri Gashi, lidhur me fushëveprimin e ministrisë, sa i përket investimeve strategjike, tha se me vendim të Qeverisë, ajo do të merret me koordinimin dhe promovimin e investimeve strategjike të Kosovës. Po ashtu, tha se këtë e bën duke përdorur rrjetet ekzistuese të bizneseve dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, do të krijohet regjistri përkatës, i cili do të jetë në dispozicion për ta promovuar Kosovën në botë për mundësitë e investimeve. Lidhur me Ligjin për investimet strategjike, tha se ky ligj është me afat të caktuar dhe se nuk e kanë parë të arsyeshme që të amendamentohet, por të fillohet me punë. Pengesë në zbatimin e këtij ligji, tha se është mungesa e rregulloreve përkatëse, por edhe pengesat në aspektin politik.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, njoftoi se Kuvendi është duke shqyrtuar Projektligjin për Buxhet dhe pyeti ministrin, nëse ka vërejtje konkrete sa i përket buxhetit të ministrisë që e udhëheq ai. Lidhur me këtë, pyeti: A është i mbuluar sa duhet fushëveprimi i ri i ministrisë, sepse do të duhen punëtorë dhe ekspertizë shtesë për ta mbuluar fushën e investimeve strategjike? A kanë bashkëpunuar me KQZ-në në zgjedhjet e fundit? Sipas saj, diaspora ka pasur probleme të shumta për të votuar në këto zgjedhje. Znj. Osmani-Sadriu, tha se ministria duhet të ndërtojë që problemet të eliminohen, sepse kjo po rezulton me shkeljen e të drejtës kushtetuese të qytetarëve që jetojnë në diasporë, lidhur me të drejtën e tyre të votimit. Sa i përket Ligjit për Diasporën, kërkoi të informohet më shumë rreth tij, nëse ministria është duke e hartuar dhe kërkoi që komisioni të përfshihet në një fazë të mëhershme të hartimit të tij. Lidhur me marrëveshjet e arritura me Republikën e Shqipërisë, znj. Osmani-Sadriu, tha se ato duhet t'i përcillen edhe komisionit. Për rrjetin e bizneseve, pyeti: A ka bashkëpunim me MPJ-në, në mënyrë që diplomacia ekonomike të jetë e koordinuar edhe me ambasadat e Kosovës?

**Evgjeni Thaçi-Dragusha**, tha se ministri mund të llogarisë në bashkëpunimin dhe ndihmën e komisionit dhe se është inkurajues fakti që janë nënshkruar marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Ajo pyeti: Pse nuk janë aktive dy qendrat kulturore dhe cilat janë pengesat për mosaktivizimin e këtyre qendrave? Po ashtu, lidhur me resorin e investimeve strategjike, pyeti: Cilat janë pengesat, të cilat i ka identifikuar ministri, në lidhje me tërheqjen e investimeve strategjike? Lidhur me Ligjin për administratën, pyeti: Cilat janë pengesat në zbatimin e këtij ligji?

**Time Kadrijaj**, shprehu mendimin se arritja e marrëveshjeve me Republikën e Shqipërisë është një shenjë që diçka e mirë është duke u bërë për diasporën tonë. Ajo tha se Kosova është shtet dhe ekziston mundësia që të investohet në hapjen e shkollave shqipe në diasporë, ku nxënësit shqiptarë kanë mundësi të mësojnë në gjuhën shqipe. Znj. Kadrijaj përmendi “Samitin e Diasporës”, të organizuar në Tiranë nga Republika e Shqipërisë dhe tha se një samit i tillë mund të organizohet edhe në Kosovë. Lidhur me qendrat kulturore, tha se ato funksionojnë në baza vullnetare dhe se do të ishte mirë që të legjitimohen. Sa i përket organizimit të zgjedhjeve në diasporë, tha se ka vërejtur që ambasadat e Kosovës nuk janë marrë me këtë proces dhe do të ishte mirë që votimi të organizohet në ambasadat e Kosovës, sepse do të ishte më legjitim. Znj. Kadrijaj, tha se Ligji për Diasporën dhe Ligji për investime strategjike, do të duhej të krijonin lehtësira administrative, në mënyrë që gjithë ata njerëz që dëshirojnë të investojnë në Kosovë t’u krijohen kushte dhe mundësi.

**Danush Ademi**, lidhur me emërtimin e qendrave kulturore, shtroi pyetjen nëse këto qendra u dedikohen vetëm shqiptarëve apo edhe komuniteteve tjera të Kosovës, që jetojnë në diasporë.

**Zafir Berisha**, njoftoi se në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, është vizituar diaspora dhe gjendja e qendrave kulturore nuk ka qenë e kënaqshme. Pyeti ministrin: Çfarë do të bëhet në drejtim të hartimit dhe zbatimit të projekteve konkrete që lidhen me diasporën? Sipas tij, dihet gjendja e diasporës, si dhe ajo e arsimit në diasporë. Sa i përket investimeve strategjike, pyeti: A do t’i jepet përparësi vetëm investitorëve që vijnë nga diaspora apo edhe investitorëve të tjerë? Po ashtu, z. Berisha pyeti ministrin: Cili është mendimi i tij që në kuadër të projekteve për diasporën, të jetë edhe një program i veçantë për diasporën në Radiotelevizionin e Kosovës dhe a ka përfunduar dhe sa është arritur objektivi i regjistrimit të diasporës?

**Aida Dërguti**, pyeti ministrin: A ka ndonjë plan konkret për “kthimin e trurit” në Kosovë, posaçërisht në fazën e shtetndërtimit dhe zhvillimit ekonomik, që janë më së të domosdoshme?

**Dukagjin Gorani**, kërkoi nga ministri të qartësojë se çka nënkuptohet me investime strategjike. Pyeti ministrin: Investimet strategjike, a përfshijnë vetëm investimet nga diaspora apo mërgata, apo edhe investime strategjike që dalin nga kontesti i mërgatës dhe diasporës dhe përfshijnë investime në kontestin socio-ekonomik?

**Visar Ymeri**, sa i përket marrëveshjeve të nënshkruara me Republikën e Shqipërisë, tha se është rruga e duhur, sepse mërgata nuk është e ndarë në Kosovë dhe Shqipëri, por jetojnë si shqiptarë dhe se institucionet e të dy vendeve duhet të investojnë në ngritjen e kapaciteteve të përbashkëta. Pyeti ministrin rreth Kartonit të Gjellbër për sigurimin e automjeteve: Cili do të jetë plani konkret i ministrisë rreth kësaj çështjeje? Po ashtu, z. Ymeri duke iu referuar Strategjisë për diasporën për vitet 2013-2018, pyeti ministrin: Si planifikohet përfaqësimi i diasporës në Kuvend, a është diskutuar kjo çështje me Kryeministrin apo dikë tjetër në Qeveri? Ai shprehu mendimin se përfaqësimi i diasporës në Kuvend do t’i shtonte vlerë skenës politike.

**Doruntinë Maloku-Kastrati**, pyeti ministrin: A është MeDIS pika e kontaktit të investitorëve potencial, duke marrë parasysh faktin që deri më tani shumë investitorë kanë kontaktuar ministri tjera, si janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe se a është KIESA nën ombrellën e MeDIS apo vazhdon të jetë nën ombrellën e MTI-së? A do të ketë ndikime buxhetore çështja e asistencës sociale që do të ofrohet nga qendrat kulturore?

**Dardan Gashi**, sa i përket buxhetit të ndarë për vitin 2018, tha se kanë kërkuar staf plotësues, se i është aprovuar buxheti shtesë, në vlerë prej 600 mijë euro dhe nuk kanë ndonjë vërejtje rreth buxhetit të ndarë për ministrinë. Lidhur me pyetjen e deputetes Maloku, lidhur me KIESA-në,

njoftoi se kanë bashkëpunim të ngushtë me MTI-në dhe janë duke përpiluar udhëzime dhe rregullore për zbatim të ligjit. Z. Gashi tha se bashkëpunimi me MPJ-në do të jetë sistematik dhe se me këtë do të funksionalizohet edhe diplomacia ekonomike. Ministri theksoi se sfidat e investitorëve për të investuar në Kosovë ka shumë, duke filluar nga administrata e deri tek infrastruktura. Ai përmendi çështjen e mungesës së energjisë elektrike, si sfidë kryesore dhe se dëmet që i shkaktohen prodhuesve nga mungesa e rrymës elektrike nuk kontrollohen nga askush. Ministri Gashi tha se kanë pasur problem me operatorin e rrjetit elektrik KEDS, i cili ka zbatuar një praktikë të dëmshme për qytetarët, sepse për t'u kyçur në rrjet kanë kërkuar që t'u transferohen pronat, aty ku vendosen trafo. Për këtë çështje, ministri njoftoi se kanë ndërhyrë në disa raste, por nuk ka përgjigje të madhe prej qytetarëve që të ndryshohen këto kontrata të dëmshme. Më tej, tha se KEDS-i e ka ndalë këtë praktikë, por tokat nuk ua kanë kthyer pronarëve.

**Dukagjin Gorani**, lidhur me këto kontrata, pyeti nëse KEDS i ka detyruar pronarët qoftë të bizneseve, qoftë privat, të heqin dorë apo ta falin një pjesë të pasurisë si kusht për kyçje. A po merret KEDS-i me patundshmëri dhe në çfarë faze është ndërprerë ky aktivitet i KEDS-it?

**Dardan Gashi**, duke iu referuar pyetjeve të deputetit Gorani, tha se në kontrata thuhet se qytetari në mënyrë vullnetare heq dorë nga prona. Arsyetimi i KEDS-it ka qenë se ata duhet të kenë qasje 24 orë në atë pronë. Po ashtu, tha se KEDS-i ka shtuar patundshmëri dhe se kjo praktikë tashmë është ndërprerë, në bazë të intervenimit të ministrisë, edhe pse nuk është ndërmarrë ndonjë hap i qytetarëve dhe të bizneseve, që të kërkojnë që këto prona t'u kthehen. Sfidë tjetër për investitorë, ministri theksoi se janë vonesat në administratë dhe se ligji i ri do t'i shkurtojë këto procedura administrative. Pyetjes se çka kuptohet me investime strategjike, ministri tha se me investime strategjike kuptojmë disa fusha të turizmit, prodhimit d.m.th investim që ndikon në aspektin strategjik qoftë me energji elektrike, qoftë në turizëm. Ai njoftoi se vitin e ardhshëm, Samiti i Diasporës do të jetë i përbashkët në kuptimin formal dhe do të mbahet prapë në Tiranë. Po ashtu, ministri Gashi njoftoi se kanë mbajtur një takim me përfaqësuesit e rrjeteve të bizneseve dhe me bizneset që janë në Kosovë, për të shikuar mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Pyetjes së deputetit Ademi, ministri iu përgjigj se në kuadër të qendrave kulturore do të kenë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve edhe komunitetet jo-shumicë dhe se nuk do të përjashtohen në asnjë mënyrë. Më tej, tha se Radiotelevizioni i Kosovës obligohet me ligj që 9% e programit të jetë i dedikuar për diasporën, dhe se aktualisht, nuk mbulon as 1% të programit të tyre për diasporën dhe kërkoj nga deputetët që të ndihmojnë në këtë drejtim. Për procesin e regjistrimit të diasporës, tha se nuk ka përfunduar, se deri më tani janë regjistruar rreth 370 mijë qytetarë, duke përfshirë edhe informatat më specifike të tyre. Ai, po ashtu, tha se “kthimi i trurit” në Kosovë është një çështje shumë ambicioze për një ministri të vogël. Për taksën rrugore njoftoi se është përgjysmuar çmimi i kësaj takse, dhe në bashkëpunim me MPJ-në, Policinë dhe Byronë e Sigurimeve, është filluar një proces për lehtësimin në qasjen e taksës, duke mundësuar pagesën e kësaj takse “online”. Në pikën kufitare në Merdare, njoftoi se do të shtohen edhe pesë pika të kontrollit dhe se me këtë do të reduktohet koha e pritjes. Përfshirja e Diasporës në Kuvend, tha se është vendim politik e kushtetues dhe propozon që së paku një zëvendësministër të emërohet nga diaspora. Lidhur me investimet, ai njoftoi se pikë referuese mund të jetë secila ministri që është e lëmit përkatës, se në Kosovë nuk ka investime që nga viti 2007 dhe KIESA vazhdon të jetë nën ombrellën e MTI-së.

**Dukagjin Gorani**, lidhur me energjinë elektrike, pyeti: Si e sheh ministri procesin aktual të ndërtimit të termocentralit të ri dhe a është e përfshirë ministria në këtë proces?

**Dardan Gashi**, duke iu referuar pyetjes së deputetit Gorani, njoftoi se termocentrali është në përfundim në kuptim të negocimit dhe se ministria nuk është e përfshirë në këtë proces, për arsye se ky proces ka filluar, para se të miratohet Ligji për investime strategjike.

**Zafir Berisha**, duke u ndërlidhur me përgjegjësitë e ministrit kur ka qenë anëtar në Komisionin Ndërmintor për shitjen e distribuimit të energjisë elektrike, e pyeti atë: A mendon që operatori i tanishëm është i papërgjegjshëm sa që e pengon edhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe a ka formë dhe hapësirë për penalizim, për shkak të operimit të paligjshëm?

**Dardan Gashi**, njoftoi se kontrata ka procedurat e penalizimit dhe ministrat përgjegjës duhet të marrin dhe të kontrollojnë kontratën dhe të shohin se a është duke i përmbushur KEDS-i të gjitha obligimet që i ka.

**Visar Ymeri**, duke iu referuar ministrit, lidhur me investimet strategjike, shprehu mendimin se është krijuar një konfuzion institucional në mungesë të ndarjes së qartë të përgjegjësive dhe detyrave që i kanë ministratë e caktuara. Ai pyeti: Nëse investimet që do të bëhen në turizëm dhe energji e që janë të ndara në mes të MZHE-së dhe MTI-së, a do të mbulohen edhe nga MeDIS?

**Dardan Gashi**, njoftoi se Komisioni Ndërmintor e ka për detyrë të verifikojë një investitor, nëse e ka fuqinë financiare dhe nëse ka projekte të ngjashme në vende tjera dhe vendos në bazë të këtyre kriterëve, se a i përmbush kushtet që të kualifikohet si investitor strategjik. Mundësi tjetër e ndihmesës për investitorët nga MeDIS, është dhënia e tokave publike apo ndërmarrjeve të pa-privatizuara, në shfrytëzim me kushte dhe kohëzgjatje të caktuar.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, kërkoi nga ministri që për çështjet, si buxheti, qendrat kulturore dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me masat që i merr ministria lidhur me të drejtat e qytetarëve të diasporës, t'i përcillet komisionit në raportin me shkrim.

#### 4. Të ndryshme

**Visar Ymeri**, kërkoi që të ftohet ministri i Ministrisë së Punëve të Jashtme, z. Behgjet Pacolli, që të raportojë në komision lidhur me deklaratën e tij, ku i ka bërë thirrje ministrit Daçiq, që së bashku ta shpallin Mitrovicën zonë të lirë ekonomike. Lidhur me këtë, shprehu mendimin se është skandaloze, nëse ka thënë ashtu dhe se duhet të japë përgjegjësi para komisionit.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, u pajtua me propozimin e deputetit Ymeri dhe njoftoi se ai është ftuar që të raportojë për këtë çështje dhe çështje të tjera, por deri më tani nuk kemi ndonjë konfirmim nga ana e MPJ-së. Ajo njoftoi anëtarët e komisionit për ftesat që i ka pranuar në emër të komisionit, për të zhvilluar vizita zyrtare në SHBA dhe Hungari, për të cilat tha se nuk ende nuk janë shqyrtuar nga Kryesia e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

\_\_\_\_\_  
Vjosa Osmani-Sadriu